



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

PROJEKT VENDIM

NR. _____ DATË _____

**PËR
MIRATIMIN E TAVANEVE PËRFUNDIMTARE TË BUXHETIT
AFATMESËM 2025-2027**

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore", Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr.68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore", Udhëzimit nr.23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit Buxhetor Afatmesëm të njësisve të vetqeverisjes vendore, Udhëzimit nr.3 datë 28.02.2024 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027", Udhëzim plotësues nr.8 datë 05.07.2024 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027", VKB nr.01 datë 30.01.2024 "Për miratimin e të ardhurave afatmesme për Buxhetin afatmesëm 2025-2027", Kontrata Nr.02C0317 për projektin RIWET lidhur më 09.04.2024, Marrëveshjes standarte mes programit të kombeve të bashkuara për zhvillim dhe Bashkisë Përmet nr.1022 datë 15.04.2024 për projektin "Askush të mos mbetet pas" ,Faza 2 ,Këshilli Bashkiak, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë tavanet përfundimtare për Buxhetin Afatmesëm për vitet 2025-2027, për Bashkinë Përmet.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhet-Financë dhe Tatim-Taksave /Sektori i Buxhet -Financës dhe administrata e bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR I BASHKISË
Alma HOXHA



TAVANET BUXHETORE 2025-2027

ne 000/leke

| | 2025 | 2026 | 2027 |
|--|-------------------|-------------------|-------------------|
| AA135 Planifikim Menaxhim | | | |
| Paga dhe sigurime | 48455.00 | 48455.00 | 48455.00 |
| Te tjera shpenzime korrente | 13540.00 | 13540.00 | 13540.00 |
| Shpenzime Kapitale | 4545.00 | 6505.00 | |
| Tavanet e pergjithshme | 66540.00 | 68500.00 | 61995.00 |
| AB135 Sherbimet publike komunitare dhe infrastruktura | | | |
| Paga dhe sigurime | 91182.00 | 91182.00 | 91182.00 |
| Te tjera shpenzime korrente | 35589.547 | 36437.074 | 38445.586 |
| Shpenzime Kapitale | 24691.00 | 53084.00 | 61237.00 |
| Tavanet e pergjithshme | 151462.547 | 180703.074 | 190864.586 |
| AC135 Arsimi dhe kujdesi social | | | |
| Paga dhe sigurime | 58868.00 | 52746.00 | 52746.00 |
| Te tjera shpenzime korrente | 27469.00 | 25427.00 | 30427.00 |
| Shpenzime Kapitale | 21065.00 | 295.00 | 600.00 |
| Tavanet e pergjithshme | 107402.00 | 78468.00 | 83773.00 |
| AD135 Argetim dhe Zhvillim | | | |
| Paga dhe sigurime | 14298.00 | 14298.00 | 14298.00 |
| Te tjera shpenzime korrente | 4753.00 | 2502.00 | 5000.00 |
| Shpenzime Kapitale | | | |
| Tavanet e pergjithshme | 19051.00 | 16800.00 | 19298.00 |
| AE135 Siguria e Qytetarit dhe Mbrojtja e Mjedisit | | | |
| Paga dhe sigurime | 24150.00 | 24150.00 | 24150.00 |
| Te tjera shpenzime korrente | 882.00 | 1367.00 | 2000.00 |
| Shpenzime Kapitale | | | |
| Tavanet e pergjithshme | 25032.00 | 25517.00 | 26150.00 |
| AF135 Rezerva dhe kontigjenca | | | |
| Paga dhe sigurime | | | |
| Te tjera shpenzime korrente | 3700.00 | 3800.00 | 3800.00 |
| Shpenzime Kapitale | | | |
| Tavanet e pergjithshme | 3700.00 | 3800.00 | 3800.00 |
| Totali I pagave | 236953.00 | 230831.00 | 230831.00 |
| Totali I shpenzimeve | 85933.547 | 83073.074 | 93212.586 |
| Totali I Shpenzimeve Kapitale | 50301.00 | 59884.00 | 61837.00 |
| Total Tavani I Pergjithshem | 373187.547 | 373788.074 | 385880.586 |

KRYETAR I BASHKISE
ALMA HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET



Permet, më ____ . ____ .2024

RELACION

PËR
MIRATIMIN E TAVANEVE PËRFUNDIMTARE BUXHETORE 2025-2027

Të nderuar Këshilltarë,

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore", Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për manaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr.68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore", Udhëzimit nr.23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit Buxhetor Afatmesëm të njësisve të vetqeverisjes vendore, Udhëzimit nr.3 datë 28.02.2024 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027", Udhëzim plotësues nr.8 datë 05.07.2024 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027", VKB nr.01 datë 30.01.2024 "Për miratimin e të ardhurave afatmesme për Buxhetin afatmesëm 2025-2027", Kontrata Nr.02C0317 për projektin RIWET lidhur më 09.04.2024, Marrëveshjes standarte mes programit të kombeve të bashkuara për zhvillim dhe Bashkisë Permet nr.1022 datë 15.04.2024 për projektin "Askush të mos mbetet pas", Faza 2, Këshilli Bashkiak, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

TAVANET BUXHETORE 2025-2027

ne
000/leke

| | | 2025 | 2026 | 2027 |
|--------------|--|-------------------|-------------------|-------------------|
| AA135 | Planifikim Menaxhim | | | |
| | Paga dhe sigurime | 48455.00 | 48455.00 | 48455.00 |
| | Te tjera shpenzime korrente | 13540.00 | 13540.00 | 13540.00 |
| | Shpenzime Kapitale | 4545.00 | 6505.00 | |
| | Tavanet e pergjithshme | 66540.00 | 68500.00 | 61995.00 |
| AB135 | Sherbimet publike komunitare dhe infrastruktura | | | |
| | Paga dhe sigurime | 91182.00 | 91182.00 | 91182.00 |
| | Te tjera shpenzime korrente | 35589.547 | 36437.074 | 38445.586 |
| | Shpenzime Kapitale | 24691.00 | 53084.00 | 61237.00 |
| | Tavanet e pergjithshme | 151462.547 | 180703.074 | 190864.586 |
| AC135 | Arsimi dhe kujdesi social | | | |
| | Paga dhe sigurime | 58868.00 | 52746.00 | 52746.00 |
| | Te tjera shpenzime korrente | 27469.00 | 25427.00 | 30427.00 |
| | Shpenzime Kapitale | 21065.00 | 295.00 | 600.00 |
| | Tavanet e pergjithshme | 107402.00 | 78468.00 | 83773.00 |
| AD135 | Argetim dhe Zhvillim | | | |

| | | | | |
|--------------|--|-------------------|-------------------|-------------------|
| | Paga dhe sigurime | 14298.00 | 14298.00 | 14298.00 |
| | Te tjera shpenzime korrente | 4753.00 | 2502.00 | 5000.00 |
| | Shpenzime Kapitale | | | |
| | Tavanet e pergjithshme | 19051.00 | 16800.00 | 19298.00 |
| AE135 | Siguria e Qytetarit dhe Mbrojtja e Mjedisit | | | |
| | Paga dhe sigurime | 24150.00 | 24150.00 | 24150.00 |
| | Te tjera shpenzime korrente | 882.00 | 1367.00 | 2000.00 |
| | Shpenzime Kapitale | | | |
| | Tavanet e pergjithshme | 25032.00 | 25517.00 | 26150.00 |
| AF135 | Rezerva dhe kontigjenca | | | |
| | Paga dhe sigurime | | | |
| | Te tjera shpenzime korrente | 3700.00 | 3800.00 | 3800.00 |
| | Shpenzime Kapitale | | | |
| | Tavanet e pergjithshme | 3700.00 | 3800.00 | 3800.00 |
| | | | | |
| | Totali I pagave | 236953.00 | 230831.00 | 230831.00 |
| | Totali I shpenzimeve | 85933.547 | 83073.074 | 93212.586 |
| | Totali I Shpenzimeve Kapitale | 50301.00 | 59884.00 | 61837.00 |
| | Total Tavani I Pergjithshem | 373187.547 | 373788.074 | 385880.586 |

Në këtë material janë përfshirë fondet që priten për dy projekte RIWET dhe "Askush të mos mbetet pas", faza 2 si dhe fondet e bashkëfinancimit nga SASPAC si të ardhura të pritshme për projektin RIWET.

Edhe për vitet buxhetore 2025-2027 ne parashikojmë 6 programe buxhetore siç kishim parashikuar në vitin 2024.

Udhëzimi plotësues nr.8 datë 05.07.2024 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027", nuk paraqiste ndryshime ne transferata edhe pse per disa funksione kanë dalë VKM per rritje fondi pagash.

Në material niveli i pagave është sipas kuadrit ligjor aktual pa ndryshime.

Për shkak të ndryshimit të projektit të Rrugës Qilarisht ulet vlera prej 11265561.87 leke ne vitin 2024 dhe shtohet vlera prej 25019011.87 ne vitin 2026.

Sipas rekomandimeve të Ministrisë së Financave edhe per kete fazë në këto tavane nuk paraqiten investimet me fonde te kushtëzuara sipas Ministrive të Linjës dhe Projektet me financim të huaj jashtë skemës së Thesarit.

Në zbatim të Udhëzimit nr.03. datë 28.02.2024 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027" në fazat vijuese të prgatitjes së PBA-së do të paraqesim për miratim zërat e detajuar .

Duke ju falenderuar!

KRYETAR I BASHKISË

Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

P/VENDIM

Nr. ___ datë ___ / ___ 2024

PËR

**KALIMIN E LISTËS SË TË MOSHUARVE PËRFITUES NË PROJEKTIN «TË MOSHUAR
JO TË VETMUAR, AKTIV DHE TË LUMTUR»**

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit 12/2016 «Për shërbimet e mbrojtjes sociale në Republikën e Shqipërisë», V.K.M Nr.658 date 17.10.2005 "Për standartet e shërbimit shoqëror në Republikën e Shqipërisë, Marrëveshjen Nr.1022 Prot. datë 15.04.2024 midis Programit të Kombeve të Bashkuara për zhvillim dhe Bashkisë Përmet në zbatim të programit «Askush të mos mbetet pas», VKB Nr.30 datë 30.04.20254 «Për një shtesë dhe ndryshim në VKB Nr.97 datë 18.12.2023», Këshilli i Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

1. Të miratojë listën e të moshuarve përfitues në projektin "Të moshuar jo të vetmuar, aktiv dhe të lumtur", si mëposhtë:

| Nr | Emër | Mbiemër |
|----|-----------|---------|
| 1 | Andromaçi | Shuraja |
| 2 | Marjeta | Çako |
| 3 | Ollga | Meshini |
| 4 | Verore | Fejzo |
| 5 | Ligor | Shyti |
| 6 | Ervehe | Caushi |
| 7 | Jorgji | Papa |
| 8 | Zyraho | Lamce |
| 9 | Anastas | Qorri |
| 10 | Fatbardha | Delilaj |
| 11 | Luljeta | Rrapo |
| 12 | Polikseni | Mboqe |
| 13 | Evelina | Nasi |
| 14 | Patra | Dimce |
| 15 | Fadile | Ahmeti |
| 16 | Polikron | Fico |

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përfshirjes Sociale, Arsim-Kulturë, Sporte dhe Drejtoria e Koordinimit të Integritimit Evropian/Projekteve të huaja/ Marrëdhënieve me publikun dhe Median
3. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga projektura

**KRYETAR I BASHKISË
ALMA HOXHA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Përmet, më 26.07.2024

RELACION

PËR
KALIMIN E LISTËS SË TË MOSHUARVE PËRFITUES NË PROJEKTIN «TË
MOSHUAR JO TË VETMUAR, AKTIV DHE TË LUMTUR»

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit 12/2016 «Për shërbimet e mbrojtjes sociale në Republikën e Shqipërisë», V.K.M Nr.658 date 17.10.2005 "Për standartet e shërbimit shoqëror në Republikën e Shqipërisë, Marrëveshjen Nr.1022 Prot datë 15.04.2024 midis Programit të Kombeve të Bashkuara për zhvillim dhe Bashkisë Përmet në zbatim të programit «Askush të mos mbetet pas», VKB Nr.30 datë 30.04.20254 «Për një shtesë dhe ndryshim në VKB Nr.97 datë 18.12.2023»

Periudha e implementimit: Prill 2024- Mars 2025

Grupi i synuar i projektit është mosha e tretë ose pensionistët të cilët jetojnë vetëm pa asnjë të afërm pranë. Ata përbëjnë një numër të lartë të komunitetit të Bashkisë, duke pasur parasysh që zona e Përmetit njihet për nivelin e lartë të emigracionit si brenda dhe jashtë vendit. Përfitimet e grupit të synuar lidhen kryesisht me:

Ofrimin e shërbimit të asistencës shtëpiake, sociale dhe shëndetësore në ambientin natyral familjar të ofruar nga një staf i kualifikuar (Infermier, Psikolog dhe Punonjës Social), për të moshuarit e identifikuar që jetojnë pa asnjë të afërm.

Hapat e ndjekur për procesin e përzgjedhjes së individëve përfitues:

1. Me nisjen e implementimit të projektit, Bashkia Përmet lidhi Marrëveshje me Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Përmet për bashkëpunimin e stafit të dy institucioneve gjatë zbatimit të aktiviteteve të projektit dhe jo vetëm.
2. Gjatë aplikimit të projektit, Bashkia i është referuar situatës së Pandemisë Covid 19 dhe problematikave apo kërkesave të komunitetit, sidomos për moshën e tretë si dhe referuar Planit Social të Bashkisë Përmet 2019-2023 ku kjo kategori gjithashtu është prioritet për tu mbështetur.
3. Pas disa takimeve me Grupin e Punës për zbatimin e projektit i ngitur me Urdhër Nr.188 datë 04.06.2024, Nr.1462 Prot datë 04.06.2024, përcaktuam kriteret për të moshuarit që do të përzgjidheshin bazuar edhe në synimin dhe objektivat e Projektit, referuar edhe Planit Social, kategoria që do të ishte prioritet do të ishte:
 - Të moshuar të cilët jetojnë vetëm pa asnjë të afërm pranë
 - Që kanë sëmundje kronike shoqëruese
 - Vështirësi financiare për të përballuar disa shërbime



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

- Pamundësi për ti marrë shërbimet pranë institucioneve përkatëse
 - Banojnë në Përmet
4. Pas përcaktimit të kriterëve, janë realizuar së bashku me NJVKSH takime me mjekët e familjes për të patur një listë të të moshuarve që përmbushin këto kriterë.
 5. Pas disponimit të një liste me 100 të moshuar, kemi arritur në listën përfundimtare me 16 të moshuar, numër ky i përcaktuar në projekt si përfitues të shërbimeve.
 6. Konsultimi përfundimtar arriti në emrat e mëposhtëm:

| Nr | Emër | Mbiemër |
|----|-----------|---------|
| 1 | Andromaqi | Shuraja |
| 2 | Marjeta | Çako |
| 3 | Ollga | Meshini |
| 4 | Verore | Fejzo |
| 5 | Ligor | Shyti |
| 6 | Ervehe | Caushi |
| 7 | Jorgji | Papa |
| 8 | Zyraho | Lance |
| 9 | Anastas | Qorri |
| 10 | Fatbardha | Delilaj |
| 11 | Luljeta | Rrapo |
| 12 | Polikseni | Mboqe |
| 13 | Evelina | Nasi |
| 14 | Patra | Dimce |
| 15 | Fadile | Ahmeti |
| 16 | Polikron | Fico |

7.Kjo është lista përfundimtare për miratim nëse nuk do të ketë sugjerime nga Komisioni i Përkrahjes Sociale apo antarët e Këshillit Bashkiak.

Faleminderit
Drejtorja e Përfshirjes Sociale, Arsimit-Kulturë, Sporte
Arjana Papapano



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

P/ VENDIM

Nr. _____ dt _____ / _____ / 2024.

PËR
MIRATIMIN E SHPENZIMEVE TË VARRIMIT TË SHITETASIT Z. Alfret FEKUSHI

Këshilli Bashkiak Permet i mbledhur më datën: _____ / _____ / 2024, bazuar në Ligjin nr. 139/2015, datë 19.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar neni 8, Neni 24/1, Neni 40/6, neni 54, neni 64/c, pika 7, Në ligjin nr.9220, datë.15.04.2004 "Për shërbimin publik të varrimit", i ndryshuar me Ligjin nr. 80/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9220, datë 15.4.2004, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga specialisti i Shërbimeve Publike, përgjegjesi i Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Shërbimit Social dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

VENDOSI:

- 1- Miratimin e mbulimit të shpenzimeve të funeralit të kryer të shtetasit Alfret Zini Fekushi në shumën 156.000 (njëqind e pesëdhjete e gjashtë mijë) lekë.
- 2- Shuma prej 156.000 (njëqind e pesëdhjete e gjashtë mijë) lekë do të përballohet nga buxheti i Bashkisë, fondi rezerve i Bashkisë për vitin 2024.
- 3- Pagesa (sipas fatures) do të kalohet të afërmes znj.Rezarta MILO .
- 4- Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Shërbimit Social.
- 5- Ky vendim hyn në fuqi 10 dite mbas shpalljes.

KRYETARI I BASHKISË

Alma HONJHA



RELACION

PËR MIRATIMIN E SHPENZIMEVE TË VARRIMIT TË SHTETASIT ALFRET ZINI FEKUSHI

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Përmet

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015, datë 19.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar neni 8, Neni 24/1, Neni 40/6, neni 54, neni 64/c, pika 7, Në ligjin nr.9220, datë.15.04.2004 "Për shërbimin publik të varrimit", i ndryshuar me Ligjin nr. 80/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9220, datë 15.4.2004, "për shërbimin publik të varrimit"

a- Të dhënat e të ndjerit.

Shtetasi **Alfred Fekushi** i datëlindjes 20.06.1982 lindur në Tiranë dhe banues në Qytetin e Përmetit, person i vetmuar, referuar të dhënave të certifikatës familjare të tij. I ndjeri njihet si person i vetmuar, e i mbyllur, i identifikuar si i tillë nga vizitat e bera nga Sektori i Mbrojtjes Sociale. Nga ana e Bashkisë Përmet nëpërmjet programeve të strehimit social në vitin 2012 ka përfituar në përmirësimin e kushteve të banimit duke ju nënshtruar rikonstruksioni i banesës së tij.

b- Ngjarja

Bashkia Përmet nëpërmjet Komisarariatit të Policisë Përmet në datën 09.06.2023 rreth orës 19³⁰ ka marrë njoftim për ngjarjen (vdekje në banesë e shtetasit *Alfred Fekushi*) banor i qytetit Përmet dhe një person i njohur i vetmuar dhe me probleme social-shëndetësore.

Referuar skedës së vdekjes së datës 09.06.2023 shtetasi Alfred Fekushi ka ndërruar jetë në banesën e tij në lagjen "Mejden" nga shkaqe të panjohura.

Mbi bazën e kësaj ngjarje Prokuroria e shkallës së Parë të Juridiksionit Gjyrokastër ka regjistruar kallzimin penal nr. 250 të vitit 2023 për veprën penale "Shkaktimi i vetevrasjes" Vërtetimi i prokurorisë nr. 2240 prot. datë 07.11.2023 konfirmon procedimin penal i cili është në fazën hetimore dhe lëshohet për efekt c'rrëgjistrimi.

c- Dokumentacioni shoqëruar

- Certificate vdekje
- Certificate personale
- Vërtetim mjekësor i shkakut të vdekjes (Skedë vdekje)
- Vërtetim Prokuroria e Shkallës së Parë Juridiksionit Gjyrokastër nr. 2240 prot. datë 07.11.2023.
- Kërkesa e të afërmit të të ndjerit znj. Rezarta Milo drejtuar Bashkisë Përmet e regjistruar me nr. 1612 prot. datë 27.06.2024 "Për mbulimin e shpenzimeve të varrimit të Alfred Zini Fekushi"
- Fatura e Agjencisë së Shërbimit funeral që mundësojë shërbimin e varrimit.

d- Mbeshtetja për përballimin e shpenzimeve të varrimit.

Nisur nga kushtet familjare të ndjerit Alfrete Fekushi (i vetmuar) ato social-ekonomike (me probleme shendetësore, i pa pune) në të cilat ndodhej ky person si dhe detyrimin që veteqeverisjet vendore kanë për përkujdesjet për varrim për këto kategori personash (Ligji nr. 80/2014, neni 6/a dhe neni 6/b Detyrimi për përkujdesje për varrimin, pika 2) për ta përcjelle atë me dinjitet për në banesën e fundit. Bashkia, ka këtë detyrim, fillimisht duke e marrë nga spitali Rajonal Gjirokastrë pasi nga strukturat e Policisë dhe Prokurorisë sipas procedurave ishte cuar për mjeksi ligjore atje dhe me pas shërbimin e varrimit në varrezat e qytetit Përmet. Ky shërbim tashmë është kryer nga një Agjensia e Shërbimit Funeral

e- Përfundime

Duke qene se ky person ishte tërësisht i vetmuar, pa asnjë familjar të afërm, ngjarja e ndodhur "Shkaktimi i vetevrasjes" në banesë, si dhe faktit tashmë që është realizuar shërbimi i varrimit i propozojmë Këshillit të Bashkisë "Miratimin e shpenzimeve të varrimit për shtetasin Alfrete Fekushi" në shumën 156.000 (tetedhjetë mijë) lekë shume e cila do të jepet të afërmes të ndjerit znj. Rezarta Milo, sipas fatures se leshuar nga Agjensia e Shërbimit Funeral e cila realizoi shërbimin e varrimit.

Konceptoi

Arian Jaupi Sp. i shërbimeve Publike.

Pranoi

Pavlina Hormoviti Pergjegjese e Zyres Juridike

Pranoi

Bekim Mecani Emergencat civile dhe mbrojtjes se qytetarit

Miratoi

Arjana Papapano Drejtore e Shërbimit Social

KRYETARE E BASHKISE

Alma HOXHANA E SHQIPËRIË





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

P/VENDIM

Nr. _____ dt _____ / _____ / 2024

**PËR MIRATIMIN E BONUSIT TË QIRASË SOCIALE TË FAMILJES SË PASTREHË,
ZNJ. NADIRE HYDA LILE**

Këshilli Bashkiak Përmet i mbledhur më datën: _____ / _____ / 2024, në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 dt 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit Nr.22/2018 "Për strehimin social", VKM Nr 459 dt. 03.07.2019 "Për rregullat për Subveccionimin e qirasë dhe mënyrën e financimit", pika 2/b dhe pika 10, Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr. 107 datë 18.12.2023 "Për miratimin e masës së qerasë mesatare të apartamenteve në treg në Bashkinë Përmet", pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga komisioni konsultativ i strehimit dhe me propozim të Kryetari të Bashkisë

VENDOSI:

- 1- Të miratojë përfitimin bonusit të qerasë sociale të familjes: **Nadire Hyda Lile** me statusin e pastrehë të miratuar me VKB nr.27 date: 03.04.2024.
- 2- Vlera e përfitimit të qerasë mujore sipas VKB nr 107 datë 18.12.2023, pika 1, gërma "c" do të jetë: **7 000 (shtatë mijë) lekë në muaj.**
- 3- Subveccionimi i qerasë do të fillojë që nga data: **1 Korrik 2024.**

| Nr | Emër, Ates, Mbiemër | Kategoria sipas nenit 16 të ligjit nr.22/18 | Nr i pjesëtareve të familjes | Kushtet e strehimit | Kushtet familjare | Kushtet sociale | Kushtet ekonomike | Total Piket | Struktura e ap. që përfiton | Masa e bonusit lek/muaj |
|----|---------------------|---|---------------------------------|---------------------|-------------------|-----------------|-------------------|-------------|-----------------------------|-------------------------|
| 1 | Nadire Hyda Lile | gërma (b) pika "1" gërma "ç" | 5 (IP/2femije m/f, 2/nipër m/m) | 6 | 0 | 0 | 15 | 21 | 2+1 | 7.000 |

- 4- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet komisioni konsultativ i strehimit, zyra e financës dhe strehimit në Bashki.
- 5- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I BASHKISË

Alma HOXHA



RELACION

NE LIDHJE ME PERFITIMIN E QERASE SOCIALE TE FAMILJES SE PASTREHE ZNJ. NADIRE
HYDA LILE , SIPAS PROGRAMEVE SOCIALE TE STREHIMIT

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Përmet

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 dt 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Ligjit Nr. Kushtet për fitimin e statusit të përfituesit nga programet sociale të strehimit, Neni 15 Rregulla të përzgjedhjes përmes sistemit të pikëzimit Neni 16 Kriteret e përzgjedhjes së përfituesve, pika a, b,c. Në sistemin e strehimit, Aplikanti: Nadire Hyda Lile ID (G25602166E) ka paraqitur kërkesë me nr aplikimi #BS051220230012 datë 05/12/2023 për përfitimin nga programet sociale të strehimit: subvencionimi i qirasë në tregun e lirë (bonus qeraje). Ne vlerësimin e kërkesave nga komisioni përparësi u jepen familjeve të divorcuara, familjeve me të ardhura të pakta, të komunitetit egjiptian, persona me aftësi të kufizuara, pensionist etj.

1. Hyrje

Bazuar në ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin Social” pranë Bashkise Përmet nëpërmjet sistemit të strehimit social Aplikanti: Nadire Hyda Lile ID (G25602166E) ka paraqitur kërkesë me nr aplikimi #BS051220230012 datë 05/12/2023 për përfitimin nga programet sociale të strehimit: subvencionimi i qirasë në tregun e lirë (bonus qeraje) Në fazën e pare të aplikimit përmban këto të dhëna:

1. *Të dhënat e aplikantit* (gjenerohen automatikisht nga sistemi duke vendosur kartën ID)
2. *Të dhënat e përfaqësuesit* (karta ID, datelindja, e-mail, nr tel)
3. *Të dhënat dhe të ardhurat e familjes* (ne fazën e parë deklarimi i te ardhurave familjare mujore nga aplikuesi)
4. **Kushtet e strehimit** (jepen arsyeet pse është i pastrehe)
5. **Kushtet familjare dhe sociale** (k/familjare, person me aftësi të kufizuara, pensionist, egjiptian etj)
6. **Forma e trajtimit sipas programeve të strehimit:**
 - *Forma e trajtimit*
 - Banesë sociale me qira
 - Banesë me kosto të ulët
 - Përmirësimi i banesës
 - *Instrumenti financiar*
 - Në mungesë të banesave sociale, ofrohet subvencionimi i qirasë në tregun e lirë
 - Në mungesë të banesave me kosto të ulët, të ofrohet, sipas mundësive buxhetore, subvencionimi i interesave të kredive.

Vendimi i Keshillit te Bashkise nr.106 date 18.12.2023 “Per miratimin e sistemit te pikezimit për programet sociale te strehimit per vitin 2024. përcakton pikët per cdo kusht familjar dhe social, mbi bazen e te cilave përcaktohen kategorite përfituese.

Vendimi i Keshillit te Bashkise nr.107 date 18.12.2023 “Për miratimin e mases së qirase mesatare te apartamenteve ne treg ne Bashkine Permet”. Sipas llojit te apartamentit (garzionere, ap 1+1, dhe 2+1) është përcaktuar masa e qerasë.

2. Vlerësimi sipas Sistemit të pikezimit i miratuar me VKB nr. 106 datë 18.12.2023 .

Vendimi i Këshillit të Bashkise nr.106 date 18.12.2023 "Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programet sociale të strehimit për vitin 2024. përcakton piket për çdo kusht familjar dhe social, mbi bazën e të cilave përcaktohen kategoritë përfituese. Vlerësimi i pikeve për këtë familje sipas tabelës nr.1

Tabela nr 1

| Nr | Emer, Ates, Mbiemer | Kushtet e strehimit | Kushtet familjare | Kushtet sociale | Kushtet ekonomike | Total Piket |
|----|---------------------|---------------------|-------------------|-----------------|-------------------|-------------|
| | Nadire Hyda Lile | 6 | 0 | 0 | 15 | 21 |

3. Vlerësimi i kërkesës nga komisioni konsultativ.

a- Të dhëna për përfituesin.

Nadire Hyda Lile, e datelindjes; 02/06/1962 me nr ID G25602166E, kryefamiljare e divorcuar. Ka paraqitur kërkesën në sistemin e strehimit me Numër aplikimi: #BS051220230012 date 05/12/2023. Referuar të dhenave nga Sistemi i Strehimit ka në përberje familjare 5 persona, të birin Ardiol Bushi i datlindjes 19/09/1996 dhe të bijen Sofika Bushi (e divorcuar) e datlindjes 19/04/1994 nipin Juan Bushi i datlindjes 18/05/2020 dhe Amari Bushi i datlindjes 11/08/2023. Nuk kanë pasuri të paluajtshme apo ndonjë ambient qe mund të perdoret për strehim referuar vertetimit hipotekor ASHK dt 21.08.2023. E punësuar në sektorin publik të pastrim-gjelberimit Bashkia Permet me page neto **35 520 lek**. Aktualisht banon në qytetin Permet me qera me adrese: 1, Nr.nd 0, Rr. Partizani.

Me VKB nr 27 datë: 03.04.2024 Nadire Lile ka përfituar statusin e pastrehe.

b-Vlerësimi nga komisioni konsultativ i strehimit.

Vendimi i Këshillit të Bashkise nr.107 date 18.12.2023 "Për miratimin e masës së qirase mesatare të apartamenteve në treg në Bashkinë Permet". Sipas llojit të apartamentit (garzionere, ap 1+1, dhe 2+1) është përcaktuar masa e qerës si më poshtë:

- a) Për apartamente të tipit Garzionere : 4 000 lek.
- b) Për apartamente të tipit 1+1 : 5 000 lek.
- c) Për apartamente të tipit 2+1 : 7 000 lek

Masa e përfitimit të qerës për këtë familje sipas tabelës nr.2

Tabela nr. 2

| Nr | Emer, Ates, Mbiemer | Perberja familjare | Struktura e ap qe perfiton | Masa e bonusit lek/muaj |
|----|---------------------|--------------------|----------------------------|-------------------------|
| 1 | Nadire Hyda Lile | 5 | 2 + 1 | 7 000 |

Sipërfaqet për çdo lloj banese sipas Vendimit nr.301, datë 15.4.2020 "Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët"

Tabela nr. 3

| Tipi i njësisë së banimit | Sipërfaqja Neto (m ²) | |
|---------------------------|-----------------------------------|-----------|
| | Minimale | Maksimale |
| Studio | 30 | 45 |
| 1+1 | 40 | 55 |
| 2+1 | 50 | 81 |
| 3+1 | 60 | 100 |

Shfrytëzimi i mundshëm i njësive të banimit sipas Vendimit nr.301, datë 15.4.2020 pika "7"

| Tipi i njësive së banimit | Numri i dhomave të gjumit | N-Numri i banorëve | Dhoma 1 | Dhoma 2 | Dhoma 3 |
|---------------------------|---------------------------|--------------------|-----------|--------------|--------------|
| Studio | - | 1-2 | 1P / çift | - | - |
| | 1 | 2 | çift | - | - |
| | 2 | 3-4 | 1P / çift | 1P / MM / FF | - |
| | 3 | 4-6 | 1P / çift | 1P / MM / FF | 1P / MM / FF |

4. Të ardhurat familjare.

Në bazë të ligjit nr.22/2018 "Për strehimin social", Neni 45 germa "c" kjo familje kategorizohet si familje me të ardhura shumë të ulëta, që janë familjet me të ardhura mujore më të ulëta se 70 për qind e të ardhurave mesatare

5. Përfundime.

Komisioni konsultativ i strehimit duke shqyrtuar kërkesën, bëri vlerësimin e kushteve të strehimit, kushtet familjare, kushtet sociale, kushtet ekonomike, referuar ligjit 22/2018 "Për strehimin social", mbas vlerësimit me pike i propozon Keshillit të Bashkisë Permet, të miratojë përfitimin e bonusit të qerasë mujore për familjen e Nadire Hyda Lile

Duke marrë parasysh edhe sugjerimet Tuaja të aprovojme përfitimin e bonusit të qerasë sociale për familjen e Nadire Hyda Lile me statusin e të pastrehe të miratuar me VKB nr.27 date 03.04.2024, duke filluar nga data 1 Korrik 2024.

Aktualisht nga Bashkia Permet trajtohen me bonus qeraje sociale 27 familje.

Komisioni Konsultativ i Strehimit:

Kryetar Aulona Meshini

Anëtar Arian Jaupi

" " Arjana Papapano

" " Entela Bejko

" " Pavlina Hormoviti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ Prot.

Datë __. __. 2024

P/VENDIM

**Për dhënie titulli : “ Nderi i sportit në vite ”
“ Mirënjohje e qytetit Përmet ”**

Në mbështetje të ligjit Nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” Neni 54 pika m,Neni 55 e në vijim, Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr.94/2022 “ Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë,nenet 8 e në vijim, si dhe të VKM- së Nr.861, datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë” Këshilli Bashkiak,me propozim të Kryetares së Bashkisë.

VENDOSI

1 – T”i japë titullin “Nderi i Sportit në vite” për

1-Jolanda Mihali, 2-Berije Nurka ,3-Sose Duralliu,4-Evgjeni Mango,5-Natasha Myrtolli, 6-Vasilika Peçi

Me motivacionin : *“Për kontribut të çmuar në zhvillimin e sportit të gjimnastikës në nivel lokal dhe kombëtar ”.*

2- T”i japë titullin “Mirënjohje e Qytetit” për

1- Rita Lame,2-Vjollca Miti, 3-Hëna Dervishi,4-Tefta Pasho,5- Mimoza Muraj,6- Marjeta Bundo,7- Zhuli Çuedari,8- Adriana Naqellari, 9- Marjeta Tako

me motivacionin :

“ Për kontribut të shquar dhe rezultate të larta si gjimnastet e para të sportit të gjimnastikës në qytetin e Përmetit,si dhe fituese të kupës në spartakiadën kombëtare në Korrik 1963”.

3 - Ky vendim shpallet brenda 10 ditëve nga data e miratimit.

KRYETARI

Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRIS

BASHKIA PËRMET

RELACION

DREJTUAR : Këshillit Bashkiak

Lënda : Propozim për dhënie titulli "Mirënjohje e Qytetit "
"Nderi i sportit në vite "

Të nderuar këshilltarë !

Me propozim të Shoqatës sportive të Basketbollit dhe Pingpongut dhe kryetares së bashkisë Përmet znj. Alma Hoxha është paraqitur para Jush dokumentacioni dhe relacioni përkatës për dhënie titulli " Nderi i Sportit në Vite " znj: Jolanda Mihali, Berije Nurka, Sose Duralliu, Evgjëni Mango, Natasha Myrtolli, Vasilika Peçi dhe titulli "Mirënjohje e Qytetit" për Znj: Rita Lame, Vjollca Miti, Hëna Dervishi, Tefta Pasho, Mimoza Muraj, Marjeta Bundo, Zhuli Çuedari, Adriana Naqellari, Marjeta Tako.

Po japim më poshtë një përshkrim të shkurtër për jetën dhe veprën e sportit të gjimnastikës të ish klubit shumësportësh Përmet 1967-1985.

Sporti i gjimnastikës e filloi aktivitetin e tij në vitin 1963, pasi më parë nuk njihej në qytetin e Përmetit. U krijua ekipi i djemve dhe në Korrik të vitit 1963 qyteti i Përmetit u përfaqësua në spartakiadën kombëtare të shkollave të mesme në Vlorë ku konkurroi për rrethet e kategorisë së dytë midis shkollave të qyteteve të Shqipërisë. Ky ekip u miratua zyrtarisht nga Federata Shqiptare e



Gjinnastikës një vit më vonë dhe mori pjesë në Kampionatin Kombëtar të të rinjve në Durrës.

Krahas ekipit të meshkujve filloi stërvitjen dhe ekipi i femrave që premtonte një të ardhme të mirë. Në korrik të vitit 1968 ato morrën pjesë në spartakiadën kombëtare të të rejave dhe u shpallën fituese midis rrethëve të kategorisë së dytë. Gjinnastet femra ndryshe nga djemtë e vazhduan sistematikisht këtë sport nën drejtimin e trajnerit Marsel Kosova ku konkurruan denjësisht për vite me rradhë dhe kanë arritur gjithmonë vende nderi përballë gjinnasteve me emër si 17 Nëntori, Partizani, Vllaznia, Skënderbeu, Labinoti, Flamurtari, Lokomotiva etj. Me rezultatet e tyre dhe kategoritë e larta që arritën si mjeshtrë sporti, kategori e parë, i rritën prestigjin dhe autoritetin e sportit të gjinnastikës në qytetin e Përmetit.

Ekipi i gjinnasteve përmetare ishte kryefjala e dhjetra aktiviteteve locale që janë zhvilluar në qytetin tonë ndër vite si: shfaqje gjinnastikore-akrobatike, manifestime fiskulturore-sportive si dhe tablo të niveleve kombëtare të zhvilluara përballë publikut përmetar. Rezultatet e larta kombëtare dhe ato locale mundësuan paisjen e palestrës së gjinnastikës me vegla të nivelit të lartë. Rezultatet e arritura në këtë sport nuk kanë qënë të lehta pasi ka filluar nga zero dhe në kushte shumë të vështira që rezikonin dhe jetën e sportisteve në ekzekutimin e ushtrimeve të vështirësive të larta, sidomos në traun e ekuilibrit, paralele, unaza etj.

Për këto arsye mendojmë se dhënia e këtyre titujve është nder i veçantë për qytetin që ka nxjerrë nga gjiri i saj sportiste me nivel të lartë përfaqësimi në sportin e gjinnastikës.

Drejtori Shërbimit Social

Arjana PAPAPANO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ prot.

Datë ____ . ____ .2024

P/VENDIM

Per miratimin e fondit te kushtezuar per bllok ndihmes ekonomike, deri ne 6% .

Në mbështetje të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" ligji nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ligji nr.9355, datë 10.03.2005 "Per ndihmen dhe shërbimet shoqërore " i ndryshuar me VKM nr.868 dt.29.12.2021 "Per disa ndryshime ne Vendimin 597 dt.04.09.2019 te K.M."Per percaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe mases mujore te perfitimit te ndihmes ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese,mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike,VKM nr.85 dt.10.02.2021,nr.617,date 22.09.2022 i perditesuar: Vendimin e Keshillit Bashkiak Permet me fondet e Buxhetit Vendor.VKB nr.97 date 18.12.2023 "Per miratimin e buxhetit te bashkise per vitin 2024 dhe percaktimin e numrit te punojseve te bashkise, institucioneve ne varesi te saj". Keshilli Bashkiak,me propozim te Kryetares se Bashkise:

VENDOSI

1. Te perfitojne ndihme ekonomike per Muajn Qershor 2024, 9 familje me nje fond prej 26.233 leke
2. Familjet qe perfitojne jane si me poshte:

| Nr | Emri, Atesia, Mbiemri | Bashkeshortja/i | N.ant. | Shuma |
|----|-------------------------|------------------------|--------|---------------|
| 1 | Ylli Guçe Pelushaj | Zylkade Qerim Pelushaj | 2 | 3.703 |
| 2 | Roland Petraq Jorgji | Divorcuar | 1 | 2.178 |
| 3 | Kadri Petrit Maska | Beqar | 1 | 2.178 |
| 4 | Klodjana Kristofor Peci | Divorcuar | 1 | 2.178 |
| 5 | Lame Enver Ferati | Silvana Kujtim Ferati | 3 | 5.227 |
| 6 | Mimoza Skender Gjoka | Divorcuar | 1 | 2.178 |
| 7 | Lefteri Mihal Tyto | Divorcuar | 1 | 3.146 |
| 8 | Flavia Musa Pelushaj | Beqare | 1 | 2.178 |
| 9 | Lulëzim Barjam Beqari | Divorcuar | 2 | 3.267 |
| | SHUMA | | | 26.233 |

- 3..Ngarkohen par zbatimin e ketij vendimi sektori buxhet-finance dhe zyra e ndihmes ekonomike.

KRYETAR I BASHKISE
Alma HOXHA

Alma Hoxha



RELACION

PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR MUAJIN QERSHOR 2024

Mbështetur në Ligjin Nr.139 datë 17.12.2015 "Për veteqeverisjen vendore" Ligji Nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" Ligji 9355 date 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" i ndryshuar me VKM Nr. 955 datë 07.12.2016 (kreu II pika 13) dhe udhëzimi nr.5 datë 17.02.2017 pika 2 i Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinise. Per percaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe mases se perfitimit te ndihmes ekonomike si dhe VKM nr.85 dt.10.02.2021, nr.868, date 29.12.2021; nr.617, date 22.09.2022 I perditësuar Vendimi i „Keshillit bashkiak Permet me fonde te Buxhetit Vendor Nr.97 date 18.02.2023" Per miratimin e Buxhetit te Bashkise per vitin 2024 dhe percaktimin e numurit te punonjesve te Bashkise ,insitucioneve ne varesi te saj" Keshilli Bashkiak ka te drejte te trajtoje me ndihme ekonomike familjet aplikuse qe nuk jane shpallur perfituse nga sistemi i pikezimit, deri 6% te bllok ndihmes ekonomike te muajit. Qershor 2024 me Vendim te Drejtorise Rajonale te Shërbimit Social Gjyrokaster. Nr.10/2022 date 27/10/2022 per dhenien e NE per periudhen 01-30-06-2024. per Bashkine Permet. (sipas vndimit te Muajit Qershor 2024)

Per sa me siper vlere e fondit te kushtezuar (bllok ndihma ekonomike) per Muajin Qershor

2024 eshte 63 familje me shumen prej 461.406 leke dhe per tu trajtuar familje me ndihme ekonomike jane ne dispozicion 6% e ketij fondi ose 27.684 leke, per Muajin Qershor 2024.

Mbeshtetur ne te dhenat per dhenien e Ndhimes Ekonomike per periudhen 1-30 Qershor 2024 kane aplikuar 3 familje nuk ka dale asnje familje fituese 63 jane perfituese ne skemen e Ndhimes Ekonomike.

Nga shqyrtimi dhe vleresimi i aplikuseve qe nuk kane mare piket e mjaftueshme per periudhen 01 Qershor deri me daten. 30 nga vleresime i SH.S.SH.rekumandojme :

Të perfitojne ndihme ekonomike nga fondi kushtezuar prej 6%, 9 familje me vlere 26.233 leke, nga ku fondi 6% ne total sipas vendimit eshte ne shumen 27.684 leke diferenca prej 1.451 lekë do te mbetet e papedorur per muajin Qershor. Trajtohen tre individe me statusin jetime me 30.000 lekë, nga 10.000 leke secili, sipas VKM Nr.868 date 29/12/2021.

Specialisti i NE

Jurigen SIMONI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ prof.

Datë _____ 2024

P/VENDIM

**PËR MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË MUAJ
KORRIK 2024**

Në mbështetje të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" ligji nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë ndryshuar, ligji nr.9355, date 10.03.2005 "Per ndihmen dhe shërbimet shoqërore "i ndryshuar, VKM nr.869 datë 29.12.2021 për disa ndryshime në VKM nr.597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë, mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike,VKM Nr 868 date 29.12.2021 "Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike",VKM Nr617 datë 22.09.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.597,date 4.9.2019 të Këshillit të Ministrave,"Për përcaktimin e procedurave,dokumentacionit dhe masës mujore,të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike". VKB nr.97 datë 18.12.2023 "Per miratimin e buxhetit te bashkise per vitin 2024 dhe përcaktimin e numrit te punojseve te bashkise, institucioneve ne varesi te saj "Keshilli Bashkiak me propozim te Kryetarit te Bashkise:

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike për Muajin **KORRIK 2024**, 29 familje me një fond **71.178 lekë**.

2. Fondet të përballohen nga struktura :

1.Gr.00.Tit.AC135.Kap.05.Art.606.Kod produkti V043AAD per shumen 71.178 leke

3. Familjet që përfitojnë janë si më poshtë:

| Nr | Emri, Atesia, Mbiemri | Bashkeshortja/i | N.ant. | Shuma/leke |
|----|--------------------------|---------------------------|--------|------------|
| 1 | Ziso Apostol Kristo | Valentina Polikron Kristo | 3 | 2400 |
| 2 | Xhilda Xhemal Selimllari | Xhilda Xhemal Selimllari | 2 | 2700 |
| 3 | Mitro Gani Zeqiri | Lefteri Rrapi Zeqiri | 4 | 3000 |
| 4 | Syrja Mehmet Hoxha | Beqar | 1 | 2600 |
| 5 | Drita Irakli Kosta | Divorcuar | 2 | 2100 |
| 6 | Lefteri Polikron Proko | E ve | 1 | 3000 |
| 7 | Andon Dhimitraq Kukureci | I ve | 2 | 3000 |
| 8 | Aferdita Nuredin Lahe | Beqare | 1 | 1800 |
| 9 | Arben Thoma Teka | Mirela Xheli Teka | 6 | 3000 |
| 10 | Viktor Josif Proko | Divorcuar | 1 | 1800 |
| 11 | Dhimo Naun Dimçi | Lindita Hysen Dimçi | 3 | 2400 |
| 12 | Vera Thanas Naqe | E ve | 2 | 2100 |
| 13 | Leonart Petro Markaj | Kristina Petraq Markaj | 3 | 2100 |

| | | | | |
|----|------------------------------|-----------------------|---|---------------|
| 14 | Thoma Aristidh Ilia | Maria Nuredin Ilia | 4 | 3000 |
| 15 | Xhensila Maksim Jahjaj | Beqare me Femijë | 2 | 2600 |
| 16 | Violeta Guce Pelushi | Beqare | 1 | 1800 |
| 17 | Engjellushe Manxho Canollari | E ve | 1 | 3000 |
| 18 | Rivelino Fatmir Doko | Hurma Leonidha Doko | 4 | 3000 |
| 19 | Bajame Fari Hysenshahaj | E ve | 1 | 1800 |
| 20 | Lida Koco Thomollari | Divorcuar | 1 | 2600 |
| 21 | Vasilika Bedri Malka | E ve | 2 | 2400 |
| 22 | Ilir Sali Jashari | Beqar | 1 | 1800 |
| 23 | Vitori Llazo Caci | Beqare | 2 | 2100 |
| 24 | Luam Ferit Zeneli | Gezime Tafil Zeneli | 4 | 3000 |
| 25 | Ilber Kudret Dalipaj | Divorcuar | 1 | 1800 |
| 26 | Kastriot Kristo Koto | Kastriot Kristo Koto | 3 | 3000 |
| 27 | Kastriot Astrit Male | Divorcuar | 1 | 2178 |
| 28 | Vangjush Thanas Mamillo | Gentiana Seit Mamillo | 3 | 3000 |
| 29 | Valbona Zenel Zaimi | | | 2100 |
| | SHUMA | | | 71.178 |

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhet-Finances dhe Tatim –Taksa/Spektori i Buxhet Financës.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR I BASHKISË
Alma HOXHA






REPUBLIKA E SHQIPËRIS
BASHKIA PËRMET

RELACION

PER DHENIE NDIHME EKONOMIKE PER MUAJIN KORRIK 2024

DREJTUAR KESHILLIT BASHKIAK

Të nderuar këshilltarë !

Në mbështetje të Ligjit Nr.139 datë 17.12.2015 " Për vetëqeverisjen vendore ",Ligji Nr.9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"i ndryshuar,Ligji Nr.9355 datë 10.03.2005 " Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore "i ndryshuar,V.K.M Nr.869 datë 29.12.2021 për disa ndryshime në V.K.M Nr.597 datë 04.09.2019 " Për përcaktimin e procedurave,dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike,V.K.M Nr.868 datë 29.12.2021 " Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike,V.K.M Nr 617 datë 22.09.2022 " Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr.597 datë 04.09.2019 të Këshillit të Ministrave " Për përcaktimin e procedurave,dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike ",V.K.B Nr.97 datë 18.12.2023 " Për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2024 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të bashkisë,institucioneve në varësi të saj,rekomandojmë të përfitojnë për muajin korrik 2024, 29 familje me një vlerë 71.178 lekë.

Drejtori Shërbimit Social
Arjana PAPAPANO